



Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

# **APLIKIM**

## **PËR TARIFËN E TRANSMETIMIT TË**

## **ENERGJISË ELEKTRIKE**

### **PERIUDHA**

**1 JANAR-31 DHJETOR 2017**



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres

Km 9 , Yrshek

Kashar, Tirane

Tel +355 4 2225581

Fax +355 4 2225581

[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

## Permbajtja

<b>I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.</b> .....	6
<b>II. Niveli i synuar i te ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit</b> .....	8
<b>III. Planifikimi i situatës energjitike për vitin 2017</b> .....	9
Ne mënyrë të përbledhur gjëni më poshtë realizimin e pritshëm për vitin 2016 si dhe parashikimin e situatës energjitike për vitin 2017: .....	9
<b>IV. Operatori i Tregut</b> .....	14
<b>V. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për vitet 2012-2016</b> .....	16
<b>VI. Llogaritja e tarifës së transmetimit për vitin 2017</b> .....	16
<b>i. Kostot kapitale</b> .....	16
<b>ii. Kostot operuese</b> .....	20
<b>iii. Tarifa e transmetimit për vitin 2017</b> .....	23



Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

## **I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.**

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit, e krijuar në 14/07/2004, është një ndër aktoret kryesore të Sistemit Elektroenergetik në Shqipëri.

OST sh.a. u nda përfundimisht ligjrisht dhe financiarisht dhe nga sh.a. KESH në Gusht të vitit 2008 pas Urdhrit të Minsitrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndarjen e pronësive mbi asetet. Tarifa e pare për ofrimin e shërbimit të transmetimit u miratua nga ana e ERE-s me Qershor 2006.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh. a. ka përgjegjësinë të (i) operojë, (ii) të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar plotësimin e kërkesave për transmetimin e energjisë elektrike. (iii) operojë tregun e energjisë elektrike në vend.

Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Më poshtë po parashtrijmë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh. a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi;

### **1. Menaxhimi i flukseve të energjisë**

Menaxhon flukset e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sistemet e tjera të ndërlidhura.

### **2. Siguria e sistemit elektroenergetik shqiptar**

Siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e nevojshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurtë, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat tekniko-ligjore.

Ruan informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrevë të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshirë informacionin mbi sigurimin e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE);

### **3. Lidhja me sistemin e transmetimit**

Harton dhe publikon procedurë transparente, të efektshme dhe jodiskriminuese për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit. Siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, si dhe ofrimin e shërbimeve në bazë të parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë procesin e lidhjes dhe shfrytëzimit të rrjetit. Krijon një mekanizëm të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit.

#### **4. Humbjet dhe shërbimet ndihmëse**

Siguron energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale. Kryen një analizë vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe harton e zbaton masat e reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të efikasitetit të energjisë.

#### **5. Shërbimet e balancimit**

Kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Rregullat e Tregut. Shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe të dispozitave të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal.

#### **6. Alokimi i kapaciteteve**

Menaxhon kapacitetin kufizuar, si dhe kryen alokimin e kapaciteteve me operatorët e rrjeteve të transmetimit fqinje, në bazë të kriterëve objektive, transparente e jodiskriminuese dhe publikon informacionin e nevojshëm në lidhje me kapacitetet ndërkufitare.

#### **7. Transmetimi i të dhënave**

Operatori i Sistemit të Transmetimit instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë gjithashtu edhe sistemin *wireless* të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrës optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-së.

#### **8. Sigurimi i informacionit**

Ofron ndaj përdoruesve të sistemit të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin e efektshëm të rrjetit të transmetimit. Shkëmben informacionin e kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje, me qëllim funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve.

#### **9. Bashkëpunon dhe raporton pranë ERE**

Përgatit dhe dërgon për miratim në ERE të gjitha aktet nënligjore dhe rregullatore sipas detyrimeve të parashikuara në ligj, të tilla si: Kodi i Transmetimit, Rregullat e Tregut, Rregullat e Lidhjeve të Reja, Rregulloret për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit etj. Raporton në ERE në lidhje me aktivitetin e saj në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore.

### Linjat e transmetimit


- 293.6 km 400 kV
- 1150.3 km 220 kV
- 34.4 km 150 kV
- 1582.2 km 110 kV

### Linjat e interkonjeksionit

- 400 kV Tirana 2 – Podgorica (MN)
- 400 kV Zemplak – Kardha (GR)
- 220 kV Fierza – Prizren (KS)
- 220 kV Koplak – Podgorica ( MN)
- 150 kV Bistrice – Myrtos (GR)

### Nënstacionet

- 1 Nst 400/220 kV, 600 MVA
- 1 Nst 400/220/110 kV, 840 MVA
- 1 Nst 400/110 kV, 300 MVA
- 1 Nst 220/110/20 kV, 486 MVA
- 9 Nst 220/110 TM kV, 1760 MVA
- 1 Nst 154/110 40 MVA



## II. Niveli i synuar i te ardhurave qe kerkohen prej tarifes se transmetimit

Tarifa synon te mbledhe te ardhura te nevojshme per te mbuluar kostot qe krijohen nga nje kompani transmetimi e miremenaxhuar qe mundohet te beje investime te kujdesshme, te minimizojë humbjet ne rrjet dhe te shmange shpenzimet e teperta.

Tarifa e transmetimit synon te shlyejë koston e aktiviteteve te meposhtme:

- a) Pronesine, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e linjave ajrore dhe kabllore, nenstacioneve te transformimit, qendrave dispeçer dhe godinave qe lidhen me to si dhe facilitetet e telekomunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese te OST-se qe nevojiten per te siguruar qendrushmerine dhe sigurine e sistemit te transmetimit.
- c) Kostot e sherbimeve te tjera ndihmese te OST-se, perfaqshire pagesat e bera OST-ve fqinje per te siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva te castit dhe pagesat (nese ka) per frekuencen dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit te energjise reaktive, qe duhen alokuar ne nje pagese per energjine reaktive
- e) Kostot per te siguruar zyra, komunikim dhe facilitete te Teknologjise se Informacionit (IT) per Operatorin e Tregut dhe te Operimit plus kostot e personelit qe lidhen me funksionimin e Operatorit te Tregut. Nga kendveshtrimi kontabel dhe jo vetem Operatori i Tregut duhet te kete llogarite e tij te ndara, sikur

te ishte nje njesi ligjore e pavarur me te ardhura te taksueshme te cilat do te sherbejne fillimisht per ndarjen operacionale te OT-se nga OST ne perputhje me parashikimet e ligjit 43/2015 te "Sektorit te Energjise Elektrike" dhe pikerisht nenit 57 pika 2 te tij.

- f) Kostot per te siguruar celjen e tregut te energjise elektrike ne vend dhe krijimin e burses se Energjise elektrike Shqiptare dhe rajonale ne perputhje me angazhimet e marre nga ana e Qeverise Shqiptare ne (i) Samitin e Vienes me dt. 27/08/2015 pjese e Procesit te Berlinit per 6 Vendet e Ballkanit Perendimor, (ii) Deklaraten e perbashket te firmosur midis Qeverise Shqiptare dhe asaj te Kosoves me dt. 30/03/2016 si dhe (iii) parashikimeve te Memorandumit te Mirkuptimit te firmosur nga ana e Qeverive, Regullatoreve dhe OST-ve te 6 Vendeve te Ballkanit perendimor ne Viene me dt. 27/04/2016.
- g) Kostot per tarifat e anetaresimit ne ENTSO-E, proces i cili eshte ne perfundim e siper dhe do te realizohet ne vitin qe vjen pas certifikimit te OST sh.a. nga ana e ERE-s dhe marjes se opinioninit perfundimtar pozitiv nga ana e Sekretariatit te Energjise ne Viene.
- h) kostove qe vijne nga zbatimi i detyrimeve qe lindin nga procesi i zbatimit te marveshjes me vendet e ENTSO-e (multilateral Agreement) lidhur me pjesmarrjen ne iniciativat Rajonale te Sigurise se Furnizimit (RCS)
- i) kostove qe lindin nga pjesmarrja dhe marja e sherbimit nga ana e Zyres Rajonale te Alokimit te kapaciteteve te interkonjeksionit ne Podgorice (SEECAO)

### III. Planifikimi i situates energjitike per vitin 2017

Ne menyre te permbledhur gjeni me poshte realizimin e pritshem per vitin 2016 si dhe parashikimin e situates energjitike per vitin 2017:

Nr.	Emertimi	Njesia e matjes	Realizimi i pritshem per vitin 2016	Parashikimi vjetor 2017
<b>I</b>	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST sh.a.</b>	<b>GWh</b>	<b>8,250</b>	<b>7,860</b>
a)	Prodhim vendas	GWh	6,000	4,905
b)	Energji ne marrje	GWh	2,250	2,955
<b>II</b>	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>8,080</b>	<b>7,699</b>
a)	Energjia elektrike e dhene	GWh	1,500	1,224
b)	Energjia elektrike per OSHEE sh.a.	GWh	5,980	5,735
c)	Energjia elektrike per konsumatoret e kualifikuar	GWh	600	740
<b>III</b>	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimit</b>			
a)	Humbjet ne GWh	GWh	170	161
b)	Humbjet ne %	%	2.06%	2.05%




Operatori i Sistemit të Transmetimit


Autotrada-Tirane- Durres  
 Km 9 , Yrshek  
 Kashar, Tirane  
 Tel +355 4 2225581  
 Fax +355 4 2225581  
 info@ost.al

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>ENERGJIA TOTALE QE HYN NE SISTEMIN E OST</b>	6,416	6,997	8,472	7,430	7,679	9,035	7,699	7,830	8,250	7,860
- Prodhimi vendas	3,788	5,032	7,467	3,956	4,449	6,712	4,343	5,475	6,000	4,905
- Energjia ne marrje	2,628	1,964	1,005	3,474	3,230	2,323	3,356	2,355	2,250	2,955
<b>ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR</b>	6,163	6,785	8,215	7,257	7,509	8,825	7,538	7,672	8,080	7,699
- Energjia e dhene	163	536	1,736	293	336	1,425	288	956	1,500	1,224
- Energjia e transmetuar per OSHEE	5,758	6,213	6,284	6,832	6,576	6,797	6,553	6,106	5,980	5,735
- Energjia e transmetuar per Klientet e Kualifikuar	242	36	194	131	597	603	697	610	600	740
Humbjet ne rrjetin e Transmetimit + Nevojat Vetike	253	211	257	173	169	210	161	159	170	161
Humbjet ne rrjetin e Transmetimit ne %	3.02	3.02	3.03	2.33	3.21	2.32	2.09	2.03	2.06	2.05

Shënim: Të dhënat janë shprehur në GWh



Grafiku i shprehur në GWh



Grafiku i shprehur në GWh

Sic dihet, prodhimi i energjise elektrike me burimet e vendit praktikisht bazohet ne hidroenergji dhe kryesisht ne prodhimin e kaskades se lumit Drin e cila jep rreth 90 % te prodhimit te pergjithshem. Ne keto kushte prodhimi vjetor i energjise elektrike me burimet e vendit eshte plotesisht i varur nga hidrollogjia e vitit dhe mund te luhatet ne kufijte nga rreth 3.5 TWh ne nje vit te thate, ne rreth 7 TWh ne nje vit te laget, duke e bere planifikimin e prodhimit te vendit, mjaft te veshtire e te pasigurte.

• Parashikimi i kerkeses per vitin 2017 dhe menyra e mbulimit te saj

Mbi bazen e te dhenave historike per dhjete vitet e fundit, rezulton se gradienti mesatar i rritjes se kerkeses per energji elektrike, qe transmetohet nepermjet rrjetit te transmetimit eshte i rendit 2%, sic paraqitet ne tabelen e meposhtme:

Viti / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2007	17.826	19.592	17.969	15.708	14.541	14.517	13.383	12.734	12.680	13.830	16.180	20.338	
2008	21.099	19.836	18.216	16.955	14.795	15.024	15.571	15.773	15.007	15.402	16.820	20.399	
2009	21.481	20.969	19.660	16.082	15.241	15.242	16.186	16.937	15.754	17.015	19.911	22.124	
2010	22.869	22.842	20.658	17.863	16.451	16.376	17.119	17.743	16.498	17.579	18.940	22.480	
2011	23.779	22.978	21.055	18.313	17.452	17.112	18.159	19.056	17.784	18.408	21.356	23.440	
2012	24.358	23.940	19.626	19.506	17.487	18.138	19.581	19.895	18.449	17.861	20.088	25.252	
2013	25.170	24.999	22.871	19.289	17.938	18.928	19.673	19.731	18.267	18.790	21.346	26.372	
2014	24.686	23.420	21.833	20.182	18.152	18.023	18.657	19.991	18.502	19.512	20.195	22.104	
2015	22.173	20.912	19.248	16.710	16.558	16.893	18.766	19.010	17.174	15.677	17.955	21.512	
2016	21.616	18.688	18.121	15.897	16.016	15.722	17.443	17.847	16.270	16.458			Mesatare
Rritja2007/2008	18,4%	1,2%	1,4%	7,9%	1,7%	3,5%	16,3%	23,9%	18,3%	11,4%	4,0%	0,3%	9,0%
Rritja2008/2009	1,8%	5,7%	7,9%	-5,1%	3,0%	1,4%	3,9%	7,4%	5,0%	10,5%	18,4%	8,5%	5,7%
Rritja2009/2010	6,5%	8,9%	5,1%	11,1%	7,9%	7,4%	5,8%	4,8%	4,7%	3,3%	-4,9%	1,6%	5,2%
Rritja2010/2011	4,0%	0,6%	1,9%	2,5%	6,1%	4,5%	6,1%	7,4%	7,8%	4,7%	12,8%	4,3%	5,2%
Rritja2011/2012	2,4%	4,2%	-6,8%	6,5%	0,2%	6,0%	7,8%	4,4%	3,7%	-3,0%	-5,9%	7,7%	2,3%
Rritja2012/2013	3,3%	4,4%	16,5%	-1,1%	2,6%	4,4%	0,5%	-0,8%	-1,0%	5,2%	6,3%	4,4%	3,7%
Rritja2013/2014	-1,9%	-6,3%	-4,5%	4,6%	1,2%	-4,8%	-5,2%	1,3%	1,3%	3,8%	-5,4%	-16,2%	-2,7%
Rritja2014/2015	-10,2%	-10,7%	-11,8%	-17,2%	-8,8%	-6,3%	0,6%	-4,9%	-7,2%	-19,7%	-11,1%	-2,7%	-9,2%
Rritja2015/2016	-2,5%	-10,6%	-5,9%	-4,9%	-3,3%	-6,9%	-7,1%	-6,1%	-5,3%	5,0%			-4,8%
Mesatare	2,4%	-0,3%	0,4%	0,5%	1,2%	1,0%	3,2%	4,1%	3,0%	2,4%	1,8%	1,0%	1,7%
													Trend
													1,0%

Mbi bazen e ketyre te dhenave, dhe duke marre ne konsiderate faktoret e meposhtem:

- uljen e konsumit te vendit ne tre vitet e fundit,
- vazhdimin e kontrollit te situates dhe planeve per zvogelimin e humbjeve jo-teknike ne rrjetin e shperndarjes, qe pritet te aplikohen ne vazhdim nga ana e OSHEE,
- rritjen potenciale te gjenerimit te PVE te lidhur ne rrjetin e shperndarjes qe ndikojne ndjeshem ne reduktimin e humbjeve jo teknike ne rrjetin e shperndarjes,
- rritjen e kerkeses per energji elektrike, e lidhur ngushtesisht me rritjen e ekonomise se vendit.

Eshte vleresuar qe rritja e pritshme e volumit te energjise elektrike qe do te transmetohet nga OST, te jete e rendit 1%, sic paraqitet edhe nga trendi i rritjes ne tabelen e mesiperme. Mbi kete baze, duke perdorur profilin e ngarkeses me baze orare per ditet e mesatarizuar te cdo muaji, eshte bere parashikimi i volumit te energjise elektrike qe do te transmetohet nepermjet rrjetit te transmetimit per vitin 2017, si ne tabelen e meposhtme:





Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres

Km 9 , Yrshek

Kashar, Tirane

Tel +355 4 2225581

Fax +355 4 2225581

info@ost.al

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
Mujore	GWh	671	527	566	478	498	473	542	560	535	559	555	671
Mesatare ditore	MWh	21,635	18,830	18,255	15,940	16,065	15,770	17,475	18,075	17,835	18,040	18,510	21,655
Orat / Ditat →		31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
1	MW	615	510	510	490	520	490	555	605	570	510	520	610
2	MW	530	450	450	440	470	430	495	515	525	460	480	535
3	MW	490	425	410	415	445	415	470	485	505	440	460	505
4	MW	475	415	415	410	440	400	455	475	500	430	450	495
5	MW	485	420	425	420	445	400	460	480	500	450	470	510
6	MW	540	480	480	460	495	440	495	510	540	520	540	585
7	MW	695	645	650	585	610	545	590	605	640	670	690	745
8	MW	925	855	825	725	715	660	705	725	740	825	845	970
9	MW	1,035	930	900	780	760	735	785	820	815	870	890	1,060
10	MW	1,060	940	900	780	765	755	825	855	850	860	870	1,045
11	MW	1,045	915	880	760	755	760	845	870	860	825	845	1,005
12	MW	1,025	890	860	750	745	770	860	880	875	810	830	965
13	MW	1,020	885	855	740	740	770	865	890	870	805	820	950
14	MW	1,030	890	855	735	735	770	860	895	870	810	830	960
15	MW	1,030	890	855	720	720	745	835	860	835	815	835	975
16	MW	1,040	885	850	700	705	725	815	840	815	830	850	1,010
17	MW	1,095	900	850	690	695	715	800	830	795	910	925	1,115
18	MW	1,200	1,005	905	700	705	730	810	840	800	1,030	1,050	1,220
19	MW	1,215	1,075	1,000	735	730	745	825	860	820	1,035	1,060	1,230
20	MW	1,195	1,060	1,030	830	775	765	845	905	915	1,000	1,030	1,235
21	MW	1,175	1,030	1,020	910	870	830	900	975	935	950	970	1,160
22	MW	1,065	925	920	835	845	840	910	910	845	850	870	1,070
23	MW	915	785	785	730	760	735	805	785	765	735	760	935
24	MW	735	625	625	600	620	600	665	660	650	600	620	765
Σ	MWh	21,635	18,830	18,255	15,940	16,065	15,770	17,475	18,075	17,835	18,040	18,510	21,655

Ne total, pritet qe konsumi bruto per vitin 2017 te jete i rendit 6.6 TWh.


Me te njejten menyre aresyetime, pra bazuar ne te dhenat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundeshme te numrit dhe volumit te kerkeses se Konsumatoreve te Kualifikuar, si dhe sasine e energjise qe nevojitet per te mbuluar humbjet ne rrjetin e transmetimit, eshte bere ndarja e kerkeses se priteshme si ne tabelen me poshte:

Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	616	478	511	412	415	417	486	498	425	442	456	579	5,735
Konsumi per KK	GWh	40	36	41	53	70	44	43	48	98	105	85	77	740
Humbje + N.V.	GWh	15	14	14	13	13	12	13	14	12	12	14	15	161
Kerkesa totale	GWh	671	528	566	478	498	473	542	560	535	559	555	671	6,636

Menyra e mbulimit te kerkeses se priteshme, eshte bere ne baze te eksperiences tashme shume vjecare, duke konsideruar prurjet ne kaskade me 75% siguri, nivelin e liqenit ne Fierze (te priteshem) ne fillim te vitit, rritjen potenciale te numrit dhe volumit te gjenerimit te PPE-ve, eksportin e mundeshem nga ana e tyre ne varesi te kushteve te tregut te brendeshem te energjise, dhe importit te energjise qe behet nga ana e OSHEE dhe konsumatoreve te kualifikuar, duke konsideruar rritjen e mundeshme te numrit te tyre dhe kerkesen per energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu per optimizimin e kaskades se Drinit, ruajtjen e kuotes ne Fierze, pra eficencen e gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjeter me nje kuote dhe rezerve energjetike optimale per te perballuar kerkesen per energji elektrike gjithmone ne rritje.

Rezultatet e llogaritjeve me baze mujore paraqiten ne tabelen e meposhtme:

Treguesit kryesore te Prodhimit, Shkembimit dhe Konsumit														
Viti 2017	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	195	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	150	170	180	235	200	115	60	45	50	65	110	170	129
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	280.0	279.4	281.6	285.1	291.7	296.4	296.2	292.9	288.0	282.6	278.1	278.1	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	279.4	281.6	285.1	291.7	296.4	296.2	292.9	288.0	282.6	278.1	278.1	280.1	
Diferenca mesatare ditore	cm	-1.8	7.6	11.3	22.2	15.1	-0.6	-10.9	-15.8	-17.9	-14.4	0.0	6.3	0.1
Prodhimi ne Fierze	GWh	115.0	85.2	81.7	54.6	56.7	88.2	114.4	124.0	123.0	111.4	75.2	94.9	1124
Prodhimi ne Koman	GWh	171.9	126.0	135.0	115.8	122.9	113.0	117.3	122.5	121.5	128.5	140.7	179.9	1595
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	91.9	68.5	75.2	65.5	68.1	59.6	60.9	63.4	63.1	68.9	77.1	99.6	862
Prodhimi ne Ashta	GWh	16.5	12.3	13.5	11.8	12.3	10.7	11.0	11.4	11.4	12.4	13.9	17.9	155
Prodhimi i Kaskades	GWh	395.4	292.0	305.5	247.8	259.9	271.5	303.6	321.3	319.0	321.2	306.9	392.3	3736
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	112	101	126	122	126	94	74	74	58	74	90	115	1167
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	507.0	392.8	432.0	370.2	386.4	365.1	378.0	395.7	376.6	396.6	396.9	507.6	4904
Konsumi i mujor	GWh	670.7	527.2	565.9	478.2	498.0	473.1	541.7	559.4	535.0	559.2	555.3	671.3	6636
Konsumi mesatar ditor	GWh	21.6	18.8	18.3	15.9	16.1	15.8	17.5	18.0	17.8	18.0	18.5	21.7	18.2
Importi mujor	GWh	164	134	134	108	112	108	164	164	158	164	158	164	1731
Importi mesatar ditor	GWh	5.3	4.8	4.3	3.6	3.6	3.6	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	5.3	4.7
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.9	0.0	0.0	0.0	0.0	1
Diferenca nga planifikimi ditore	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	671	527	566	478	498	473	542	560	535	559	555	671	6636
Konsumi i planifikuar, ditore	GWh	21.6	18.8	18.3	15.9	16.1	15.8	17.5	18.1	17.8	18.0	18.5	21.7	18.2



Nga llogaritjet, me probabilitetin e pranuar te prurjeve ne kaskaden e Drinit, (prurja mesatare vjetore ne Fierze 127 m3/s, ne Koman 65 m3/s, ne V.Dejes 23 m3/s), rezulton se prodhimi i pritshem i kaskades (pjesa e KESH) eshte i rendit 3.6 TWh, prodhimi i PPE-ve pritet te jete rreth 1.3 TWh, dhe i gjithe prodhimi i vendit rezulton rreth 4.9 TWh sic paraqitet ne table:



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres  
 Km 9, Yrshek  
 Kashar, Tirane  
 Tel +355 4 2225581  
 Fax +355 4 2225581  
 info@ost.al

Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prodhimi	GWh	507	394	433	370	386	365	378	396	377	396	397	508	4,905
	KESH GWh	379	280	293	236	248	261	293	310	308	309	293	374	3,582
	PPE GWh	128	114	140	134	139	104	85	86	69	87	104	133	1,323

Importi i energjise i realizuar nga OSHEE per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes dhe nga Furnizuesit e Kualifikuar per konsumatorete respektive, eshte kalkuluar ne menyre komplementare me probabilitetin e perzjedhur te prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasise vjetore te importit qe mund te diktohet nga ndryshimi i prodhimit te vendit si rrjedhoje e ndryshimeve te situates hidrike, sic e ka treguar ne mjaft raste eksperienca e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kerkeses per energji elektrike.

Ne tabelen e meposhtme jepet planifikimi i importit te energjise elektrike qe duhet te realizohet nga OSHEE dhe furnizuesit e kualifikuar, per probabilitetin e perzjedhur te prodhimit, qe ne total pritet te jete i rendit 1.7 TWh.

Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Importi	GWh	164	134	133	108	112	108	164	164	158	164	158	164	1,730
	OSHEE GWh	129	104	98	63	47	68	126	119	63	64	88	102	1,070
	FK → KK GWh	35	30	35	45	65	40	38	45	95	100	70	62	660

#### IV. Operatori i Tregut

Operatori i Tregut (OT), pjese e Operatorit te Sistemit te Transmetimit (OST), ne strategjine e aktivitetit te tij ka zbatimin e legjislacionit ne fuqi per sektorin e energjise elektrike ne fushen e Tregut te Energjise Elektrike (TEE). E gjithë veprimtaria e OT mbeshtetet ne strategjine e politikave te zhvillimit te OST.

OT eshte ne proces te strukturimit te tij, per nje funksionim sa me te mire ne plotesimin e detyrave te saj ne zhvillimin e TEE, ne ndjekje dhe ne perputhje edhe me zhvillimet rajonale dhe direktivat e Bashkimit Europian.

##### **Funksionet e Operatorit te Tregut (OT)**

OT, pjese e funksionit te OST, eshte pergjegjese per:

- 1) Organizimin dhe administrimin e shlyerjeve te pagesave te enegjise elektrike midis pjesmaresve te tregut per tregun e balancuar
- 2) Mbajtjen e llogarive ne emer te paleve tregtare per energjine e balancuese dhe sherbimet e kerkuara nga OST.
- 3) Menaxhon procesin e njoftimit te shlyerjeve.
- 4) Rikthen pagesat per energjine e balancuese te blere nga OST
- 5) Grumbullon dhe perpunon te dhenat e matjes
- 6) Menaxhon procesin e modifikimit te rregullave te tregut
- 7) Pergatit informacionin e tregut ne perputhje me rregullat e tregut

OT eshte pjese e struktures se OST sh.a., ne nivel Departamenti.



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

DOT administron Regjistrin e Paleve te tregut si edhe ndjek procedurat perkatese te regjistrimit te tyre mbeshtetur ne Rregullat e Tregut ( RrT ), Kodin e Sistemit te Transmetimit ( KST).

Aktualisht (Tetor 2016) jane te regjistruar ne TEE rreth 30 subjekte, prej te cileve 25 subjekte ne rolin e Tregtuesit (T), 20 subjekte ne rolin e Furnizuesit te Kualifikuar (FK), 13 subjekte plotesojne kushtet per te perfituar statusin Konsumatore te Kualifikuar (KK), 8 subjekte ne rolin e prodhuesit (P), kemi OSHEE ne rolin e Shpermdarjes, Furnizuesit Publik me Pakice (FPP), dhe tregtuesit kemi KESH sh.a. ne rolin e Prodhuesit (P), Furnizuesit Publik me Shumice (FSh) dhe ne rolin e Tregtuesit.

Ne mbeshtetje te hapjes dhe zhvillimit te tregut te kapaciteteve ne interkonjeksion, jane miratuar *"Rregulla per Alokimin e Kapaciteteve ne Interkonjeksione"*, ne Nentor te vitit 2013 si dhe rregullat per alokimin e kapaciteteve ne Zyren Rajonale te Alokimit te Kapaciteteve, "SEE CAO" e cila edhe per 2017 do te alokoje kapacitetet e dy nga tre kufijve te interkonjeksionit. Nese do te realizohet njohja e Kosoves si Bllok me vete nga ana e ENTSO-e edhe kufiri AL-KS do te alokohet ne SEE CAO.

Keshtu , ne mbeshtetje te angazhimeve te dala nga Traktati i krijimit te Komunitetit te Energjise se vendeve te Evropes Juglindore perfshire dhe Shqiperine si dhe ne mbeshtetje te obligimeve te ndermarra ne kuader te krijimit dhe funksionimit te zyres rajonale te alokimit te Kapaciteteve, CAO, kjo zyre do te realizoje procedurat e ankandevet per alokimin e kapaciteteve me baza vjetore, mujore dhe ditore.

Volumi i transakcioneve te energjise, pra edhe i kerkeses per kapacitete transmetuese ne interkonjeksion, nuk eshte proporcional pergjate gjithë muajve te vitit, parashikimi i te ardhurave qe OST mund te siguroje ne ankandet e alokimit te kapacitetit ne interkonjeksion pergjate gjithë vitit 2017 parashikohet te kete nje rënie ne krahasim me vitin 2016 ne rreth **8.6 milion Euro ose 1,200 milion leke**, duke konsideruar te ardhurat aktuale te siguruara ne ankandin vjetor per vitin 2017, i cili u zhvillua ne 20 Nentor 2016, te cilat ishin ne total 3.09 milion Euro si dhe duke pare ecurine e te ardhurave nga ankandet mujore te vitit 2016 te cilat kane pesuar rënie si pasoje e (i) mbylljes se tregut te importit te humbjeve nga ana e OSHEE dhe blerjes ne treg te brendshem nga sh.a. KESH, (ii) realizimit te eksportit nga ana e sh.a. KESH pa siguruar te drejta te rezervuara ne tregun e interkonjeksionit si dhe (iii) realizimit te kontratave te depozitimit, shkembimit dhe kompensimit ne interkonjeksion nga ana e sh.a. KESH pa rezervuar te drejta te kapaciteteve te interkonjeksionit si dhe risite e paqartesite e tregut te alokimit te kapaciteteve ne interkonjeksione nga zyra perkatese rajonale, CAO ne Podgorice apo dhe venia ne pune e linjes se interkonjeksionit 400 kV Tirana 2 – Prishtine qe do te ule ndjeshem te ardhurat qe do te mund te siguroheshin nga alokimi i kapaciteteve te interkonjeksionit. Keto te ardhura do te sigurohen nga Pjesmarresit e Tregut.

Duke filluar nga 1 Shtatori 2014 DOT ka realizuar alokimin Ditor te kapaciteteve ne interkonjeksione per Kufirin me Kosoven, procedura e cila, eshte tregues zhvillimi ne liberalizimin e tregut si edhe do te vijojte te aplikohet edhe ne vitin 2017 deri ne alokimin e saj ne SEE CAO.

Gjithashtu për vitin 2017, me ndryshimet në Ligjin 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, do të mundësohen shtimi i klienteve të cilët e blejnë energjinë elektrike në tregun e lirë.

Investimet e parashikuara apo programuara për OT janë pjesë e planeve dhe programeve të OST për vitin 2017.

I njëjti vlerësim vlen edhe për shpenzimet materiale, shpenzime për personelin, asistencë teknike për përgatitjen e rregullave të tregut, shpenzime për furnitura, trainime etj.

## V. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për vitet 2012-2016

Gate periudhës 2012-2015 si dhe gjatë vitit 2016, OST sh.a. nuk ka arritur që të arketojë të gjitha të ardhurat e lejuara nga kjo tarifë. Kjo situatë ka rënduar gjendjen financiare të kompanisë duke bërë të pamundur shlyerjen e detyrimeve të saj.

